



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



**Takim me qytetarët e lagjes Kalabria,
mbajtur më datë 26.05.2023, duke filluar nga ora 16:30.**

Në takim morën pjesë: Florim Krasniqi-kryesues, Përparim Rama- kryetar, Arbër Sadiki-drejtor, Mimoza Sylejmani- drejtore, Grupi Punues i Planit të “Kalabrisë”, si dhe qytetarët e lagjes “Kalabria”.

Takimin e hapi dhe e kryesoi: **Florim Krasniqi**.

Përparim Rama- Kryetar i Komunës, hapi takimin fillimisht, me një përshëndetje dhe mirëseardhje për qytetarët e pranishëm, në Diskutimin Publik rreth propozimeve për lagjen "Kalabria". Ai u shprehë se siç kanë premtuar do të fokusohen për zgjidhjen e problemit të mëparshëm, për të krijuar propozime që kanë me ngritë vlerën e jetesës në zonën e "Kalabrisë", duke prezantuar edhe Grupin Punues , i cili ka punuar një kohë të gjatë dhe është marrë me analizat e kësaj zone , me gjendjen ekzistuese, me gjendjet e mëparshme, me propozimet e mëparshme e po ashtu edhe me ndërlidhjen e vizionit të Kryeqytetit, për të ardhmen e Kryeqytetit. Ai prezantoi disa versione (prezantime) të cilat i kanë diskutuar së bashku me ekipin dhe shprehu pritshmërinë për një diskutim konstruktiv, me të gjithë të pranishmit para se të vazhdohet në fazën tjetër të marrjes së vendimeve rreth përfundimit të Planit Rregullativ për lagjen "Kalabria".

Ai edhe një herë falënderojë pjesëmarrësit për interesimin e madh dhe ju kërkoi një diskutim konstruktiv pa debate të nxehta, për të zgjidhur problemit për të mirën e Kryeqytetit, e posaçërisht banorët e lagjes "Kalabria".

Kryetari shprehu gatishmërinë për t’iu përgjigjur pyetjeve të qytetarëve bashkë me ekipin të cilët i marrin të gjitha pikat dhe në rast që s’mund t’iu përgjigjen të gjithave gjatë takimit, tha se do të organizojnë edhe një Diskutim tjetër ose do tu përgjigjen me shkrim, për arsye se ka të bëjë me zhvillimin e një lagjeje kyçe, me interes jo vetëm për lagjen "Kalabria" por edhe për gjithë Kryeqytetin, andaj është me rëndësi të madhe, që të ketë një dakordim të përbashkët për të ardhmen e qytetit.

Duke i falënderuar edhe një herë për prezencën kryetari ja dha fjalën Florimit i cili , i cili është kryesues i ekipit që janë marrë me zhvillimin dhe analizimin e kësaj zone.

Florim Krasniqi-Kryesues, falënderojë për pjesëmarrje de duke mos dashur të hyjë në detale të procesit të gjatë, prej kohës kur ka filluar revidimi për herë të parë i këtij plani, theksojë se në pika të shkurtra do ta bëjnë një prezantim dhe në fund të prezantimit, do ta hapin debatin e planifikuar. Si kryetari, edhe z. Krasniqi tha se do të ketë edhe takime tjera në faza të ndryshme të këtij plani, ku do të diskutohen të gjitha detalet e parapara me këtë Plan Rregullues. Ai shpjegoi se në nëntor të vitit të kaluar është marrë vendimi, për fillimin e hartimit të këtij plani, ndërsa na janar të këtij viti, me vendim të kryetarit janë caktuar si Grup Punues, në nivel të komunës, për ta hartuar Planin Rregullues në fjalë dhe se kufiri i këtij plani ka një sipërfaqe prej 355 hektarëve (ha), ku rrethohet me zonën perëndimore, me Prishtinën e re, në pjesën veriore me lagjen "Dardania" dhe në anën perëndimore me zonën ekonomike të Prishtinës. Krasniqi tha se vlen të theksohet që për herë të parë, është bërë një analizë e detajuar e rrjetit rrugor apo të infrastrukturës rrugore, ku mund ta shohim që "Rruga A", e cila ndërlidhet me tri lagje të Prishtinës, siç është: "Prishtina e Re", "Mati 1, Mati2", zona "Qendër" e Prishtinës, depërton "Rruga A", përmes "Kalabrisë" e cila do të depërtojë direkt në autoudhën, siç u pa në prezantim, me ngjyrë portokalli. Me këtë plan ai tha se vlen për tu theksuar që është krijuar edhe një qasje e re, e favorshme për zhvillim të komunikacionit sa më të lehtë për qytetarët, dhe që për herë të parë do të ketë lidhje, ndërmjet dy lagjeve, me një nënkallim, i cili është i planifikuar të realizohet, në pjesën e sipërme të "Veterrnikut", më saktësisht tek qendra tregtare "Albi Mall" e cila do ta ndërlidhë "Kalabrinë" dhe "Prishtinën e Re", zonën perëndim. Krasniqi u shprehë se ky është plani aktual, i cili është në fuqi, me të cilin është bërë një analizë e gjendjes faktike në përgjithësi, duke i marrë në konsideratë edhe nevojat për dendësinë aktuale por edhe për dendësinë e cila është planifikuar me planin e ri, ku kanë konstatuar që me këtë plan dhe me dendësinë aktuale të cilën e ka ky plan, ka mungesë të madhe të institucioneve publike, qoftë sociale apo cilat do qofshin ato. Ai prezantoi se në hartën (në ekran) në vazhdim kanë bërë analizën e dendësisë, deri më tani, të lejeve ndërtimore, të cilat janë lëshuar nga Komuna e Prishtinës dhe në bazë të saj shihet edhe tendenca e realizimit të këtij plani ndër vite, që nga miratimi për herë të parë që është bërë në 2005-tën, nga kuvendi komunal dhe se aty mund të shihet gjendja ekzistuese e shërbimeve publike në përgjithësi, d.m.th mund të vërehet që të gjitha këto janë të fokusuara vetëm në një zonë, ndërsa tek dendësia ku është zhvilluar, ka mungesë të shërbimeve publike. Përtej kësaj z. Krasniqi tregojë që kanë zhvilluar skenarin, duke e aplikuar edhe modifikimin e infrastrukturës rrugore dhe elementeve tjera urbane, kurse skenari tjetër siç e ceku edhe kryetari ka për tendencë që për herë të parë, qytetari të vendoset në qendër të vëmendjes dhe të jetë qytetari ai i cili vlen më tepër se sa një metër katror i ndërtimit, apo ndërtesat në përgjithësi. Ai tha se përmes kësaj strategjie kanë zhvilluar edhe korridore të gjelbra përgjatë infrastrukturës rrugore, ku do të ketë korridore, gjelbërime, siç shihet edhe në pjesën anësore, që janë elaboruar shembujt, ku një prej tyre veç është në realizim e sipër, pra "Parku i Arbërisë", tek shkolla "7 marsi" dhe duke i krahasuar këta dy skenarë te pjesa e gjelbërimit, janë dy skenarë, me dhe pa park. Sipas tij krahasimi i këtyre dy skenarëve është për ta parë dendësinë e banimit pa vlera, të lagjes dhe skenari i parë, ku shihet që parku do ti jap një vlerë të shtuar lagjes në përgjithësi, duke mos cenuar të drejtën ndërtimore për asnjërin nga qytetarët por në anën tjetër duke e rritë mirëqenien e qytetarëve, që do të jetojnë në këtë lagje. Në anën tjetër z.

Krasniqi vazhdojë se është bërë analiza dhe nevoja e shërbimeve publike, për çerdhe, për shkolla, për ambulanta dhe të gjitha shërbimet tjera publike komfor normave të planifikimit dhe legjislacionit në fuqi, dhe se në takime tjera do të jepen detale shumë më të mëdha, për këtë pjesë.

Po ashtu ai u shpreh përmes tabelës, se në bllok ndërtimor, kanë bërë analiza të ndërtueshmërisë në përgjithësi dhe në bazë të kalkulimeve dhe dendësisë së përgjithshme të lagjes, kanë ardhur në përfundim që në fund, kur të realizohet i gjithë plani, do të jetë një dendësi e banorëve rreth 90 mijë banorë që do të jetojnë në kuadër të kësaj lagjes.

Përparim Rama- Kryetar, u shprehë se analizat dhe prezantimet e prezantuara nuk e cenojnën aspektin që ai e ka biseduar me banorët, d.m.th ajo që ka qenë 1.8 me u bë 2.4, nuk e cenon atë formulë, ajo qëndron, vetëm se po krijohen korridore të gjelbra, të cilat e krijojnë një mundësi të jetesës të mirë për të gjithë dhe si shembull morri lagjen "Kodrinat". Ai tha se ekziston një formulë, e thjeshtë, e mirë, e shpejtë, që është duke u përdorë në dy zona të Kryeqytetit, ku p.sh çdo zhvillim për me marrë lejen në një prej këtyre pikave ku lejohet ndërtimi, duhet të shpronësohet një tokë që është e gjelbër dhe pikërisht ajo, vjen si proces i densifikimit të asaj zone, pra mundësohet që të ketë edhe hapësira të gjelbra, të mirëfillta për qytetarët por edhe nuk i cenohet koeficienti që ka qenë më përpara, aty ku propozohet me qenë gjelbërim, pra bartet në këtë zhvillimin e ri. Kryetari Rama theksojë se kjo formulë e mirë, e thjeshtë, e shpejtë ka funksionuar dhe është ndërtuar tek "Kodrinat" dhe se kjo formulë është për të krijuar një lloj baraspeshë në mes të ndërtesave dhe hapësirave të përbashkëta, hapësirave të gjelbra, vendeve për shkolla, për çerdhe, për parkingje, p.sh mos me thënë veç po ndërtojmë ndërtesa. Tutje ai shpjegoi se relacioni i ndërtesës me tjetrën p.sh me krijimin e një baferi të gjelbër, ku veç kemi në pjesën e poshtme (gjepi i gjelbër), në pjesën e poshtme kemi ndërtesa ekzistuese, ku ekziston një numër i madh i madh i banorëve dhe nëse tash në atë baferin e gjelbër prapë ndërtohet, edhe banorët ekzistues cenohen prej një jete më të mirë por edhe zhvillimi ri i ndërtimit në atë pikë nuk e krijon një potencial që kishte me pas nëse ndërtimi i asaj zone të gjelbër bartet në anën tjetër. Kryetari prezantoi dallimin e Planit Rregullativ ekzistues, i cili ndalonte ngritjen e lartësisë duke theksuar se e kanë larguar atë dhe se s'ka më ndalesë që. p.sh mund të ndërtohet vetëm në 5 kat por mund të ndërtohet 7, 10,15, varësisht me ndërlidhjen e ndërtesës me park. Përmes këtyre zhvillimeve në "Kalabri" me këtë sistem, ai u shprehë që duan të krijojnë një ndërlidhje me hapësira të gjelbra, ku fëmijët tanë mund të luajnë në mënyrë të mirë, të lirë, të sigurt, që mund të kenë hapësira rekreacioni, e në të njëjtën kohë, jo me bë volum në tokë, jo me zënë tokë por me zvogëluar atë, me ngritë lartë gjë që krijon një lloj momentumi të ri, një hapësirë e një vend shumë më të mirë të jetesës se sa të gjitha me i shty, ndërtesë pas ndërtesë. Kryetari Rama propozojë se në vend që të krijohen vetëm ndërtesa të bëhet një relacion ku sipas mendimit të tij po krijohet një mundësi shtesë për një jetë më të mirë duke theksuar se ky është vetëm mendim profesional, ndërsa vendimin do ta marrin së bashku. Ai përmes hartave në ekran paraqiti lidhjet e gjelbra, ndërtimin e "Rrugës A" ose "Jim Xhema" që është duke u punuar, lidhjet e reja, dizajnet janë që me pas bafera të gjelbër të gjitha këto zona që të ndërlidhen parqet e ndryshme, të cilat janë të ndërlidhura

me densitet, pra sipas tij tash nuk flitet vetëm për metra katror por edhe për hapësira të mirëfillta të jetesës, e jo ndërtesë pas ndërtesë, siç është "Rruga B", ku është bërë një lloj katrahure totale, ku s'ka mundësi jetese të lirë .

Kryetari Rama tha se e kemi momentin për ta zënë këtë mundësi për të gjithë ju dhe për qytetin.

Florim Krasniqi si kryesues i takimit, sqaroi rregullat e diskutimit.

Adem Zeka- qytetar, mori fjalën duke thënë që siç e pa ai rripin e gjelbër pavarësisht e kujt është ai mendon që parqet në kodrina nuk ndërtohen, se s'duhet ai asgjë veç park, as s'duhet për lodra, as për asgjë, sepse parqet ndërtohen në pjesën më të lartë të kodrinës dhe ka një pjesë që mund ta rrafshosh, por s'mund ta rrafshosh "Kodrinën". Sipas tij relacioni në mes të ndërtesës mbetet vetvetiu, ndërsa në tokën e rrafshët është dendësia e ndërtesave, kurse në "Kodrinë" dendësia nuk mundet me qenë si në tokën e rrafshët, e ai rrip gjelbërimi pavarësisht ku është, ai mundet me qenë veç gjelbërim, e jo rekreacion. Z. Zeka tha se nëse donë edhe gjelbërim edhe rekreacion ose duhet me dal komplet në kodër atje lartë ose me ndenjtë poshtë në rrafsh.

Sami Fetahu- qytetar i cili e kishte tokën tek pjesa e gjelbër (e madhja) shprehu shqetësimin për pronën duke theksuar se kjo ka qenë edhe para planit por edhe tash kanë mbetur keq sepse kanë shumë tokë aty 2 hektar e 5-6 ari. Ai pyeti se çka do të ndodhë me ta në këtë rast sepse të tjerët s'kanë gjelbërim hiq, veç ata edhe gjelbërim i lartë po quhet.

Përparim Rama- Kryetar, morri shembull aspektin e tokezimit në lagjen "Kodrinat" për të treguar që është edhe një lagje që ka përdorë sistemin e njëjtë, ku ata që zhvillojnë ndërtimin në lagjen "Kalabria" e kanë për detyrë me marrë një përqindje prej kësaj zonës së gjelbër dhe në këtë mënyrë metrat katror që qytetari i ka pas në zonë të gjelbër, barten në zhvillimit që ndodhin në këto zonat tjera, pra nuk mbetet pa zhvillim, dhe pronari nuk dëmtohet por bartet prona e tij në këto zonat ndërtuese. Ai shpjegoi se "Kodrina" kur aplikon për ndërtim të një ndërtesë, deri në 30% duhet ta shpronësoj zonën e gjelbër dhe kështu bartet koeficienti në këto pjesë ku ndërtohet, pra kjo është zgjidhja.

Qytetari pyeti se a duhet të bëjnë kërkesë tash për këto gjëra apo qysh është muhabeti d.m.th me shikuar kush po ndërton, kush s'po ndërton ?

Përparim Rama- Kryetar, u përgjigj se si në çdo pjesë ose banorët munden vetë me u ndërlidhë me investitorë të këtyre pjesëve tjera, dhe se ata kur dikush aplikon e fusin por lejen nuk mund ta marrin pa e shpronësuar 30% të zhvillimit me tokat që janë në zonën e gjelbër , pra ajo merret si zonë për interes publik për këtë arsye shpronësimi bëhet prej investitorit. d.m.th e merr tokën e gjelbër, që mbetet e gjelbër por e transformon në metra katror në zhvillim (ndërtim), kështu që kushdo që aplikon për leje, ndërlidhet leja me këtë element sikurse është zhvilluar "Kodrina". Ai theksoj se ajo zonë nuk është peng sepse po zhvillohet dhe se përpara, në të kaluarën nuk i kanë marrë parasysh fare

banorët, ndërsa tani po i marrin parasysh dhe po e transformojmë tash koeficientin në zonat që ndërtohen.

Dardan Zogjani, pronar i kompanisë "ME Real Estate Development" tha se kishte dërguar kërkesë 2 herë, po ashtu edhe Ambasada e Amerikës pasi që ai ishte me një investitor amerikan sepse sipas tij është bllokuar gojarisht procesi në "Emshir", ku lënda për kushte ndërtimore është kryer tek zyrtarja në komunë, por që procesi nuk është vazhduar edhe pse ai ka kërkuar përgjigje me shkrim sepse është duke iu rrezikuar investimi rreth 600.000 mijë euro. Ai pyeti se çka do të bëhet me të, pasi ai ka kontratat me pronarët e tokave, ka kontrata që ka paguar tokë aty, i ka të gjitha, të cilat k bien në ujë për shkak të bllokadës pa letër.

Përparim Rama- Kryetar, pyeti qytetarin se a kërkuar kushtet me plan ekzistues apo me plan të ri?

Dardan Zogjani u përgjigj se me plan ekzistues, por që i kanë thënë që pa thënë kryetari dhe drejtori i Urbanizmit nuk mund të vazhdohet tutje.

Përparim Rama- Kryetar, specifikoi se nëse z. Zogjani ka aplikuar me plan ekzistues nuk është dashur ti ndalet procesi, dhe se të martën mund të shkojë ti marr kushtet me plan ekzistues.

Shyqri Dumani- profesor i mbrojtjes së mjedisit tha se do ta elaboroj planin rirregullues, e jo rregullues , pa marrë parasysh a pajtohen arkitektët apo jo. Sipas informatave të tij Plani Rirregullues ka për qëllim, lehtësimin e jetës së banorëve në lagje, gjegjësisht përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës , qoftë kanalizimit, qoftë ujit, qoftë parqet, parkingjeve, rrugëve, trotuareve etj.

Sipas tij vulën e së keqes, qytetit të Prishtinës ja ka dhënë Lulzim Nixha që nga viti 2008 dhe sot kjo e keqe ka vazhduar me të njëjtin trend dhe Prishtina është shndërruar në një gjungëll urbane, ku jeta është jashtëzakonisht e rëndë, Prishtina është në bllokadë, përveç nëse ecë në këmbë, përndryshe Prishtina është e ngulfatur. Profesori tha se "Kalabria" është e tëra e betonizuar, rruga " Rexhep Krasniqi" është e njëjta gjë, po ashtu gjatë ndërtimeve të larta, rrëzimi i shtëpive, ndërtimeve të ulëta, që kanë pas parqe personale (shtëpiake), çdo gjë është zhdukur dhe jeta e qytetarëve është e rënduar, nuk mundesh me ecë në këmbë. Sipas tij nëse një kompani ka marrë leje me 2-3 ari leje të ndërtimeve të larta dhe rruga ka mbet e njëjtë, kanalizimi ka mbet 30-40 milimetra, rruga e ngushtë 2 metra, trotuare nuk ka fare. Ai ka kërkuar që në rrugët 2 metra të ngritën policët e shtrirë që të mos ndodhin aksidente, siç kanë ndodhë, e madje edhe sot nëpër ato rrugë 2 metra cisternat ose mikserët tërë ditën bartin beton është ngarkesë dhe ndotje e ambientit jashtëzakonisht e madhe. Rreth fjalimit të z. Krasniqi se do të jenë diku rreth 90 mijë banorë në një sipërfaqe 355 hektarë, ai reagoi duke thënë se është mbingarkesë dhe për kë po ndërtohet, për këta qytetarë që sëmundjeshmëria e tyre e tyre është në rritje e sipër, ku fëmijët shumica prej tyre, kanë deformime, jo vetëm fizike por edhe shpirtërore.

Z. Dumani u shprehë se nuk ka askund në botë ku rrëzohen ndërtimet e ulëta dhe ngritën ndërtimet e larta dhe në fund pati një lutje për kryetarin që ti ndërpresë këto gjëra, mos të ngulfatet qyteti, të lihen ndërtimet të ulëta dhe të zgjerohet qyteti në periferi, ku janë sipërfaqet e lira dhe aty të ndërtohet me plane të mirëfillta urbanistike, me infrastrukturë të mirëfilltë urbanistike dhe jo në mënyrë të egër, sipas interesave.

Muharrem Hondozi- qytetar, u interesua për kufijtë e "Përroskës së Matit", 130 metra te "Star Prishtina", restorant "Bashçe", ku për po thuajse për 20 vite ai është peng i pronës së tij edhe pse ai i ka bërë padi komunës së Prishtinës por fatkeqësisht s'ka funksionuar, s'ka funksionuar komuna për 20 vite e as gjyqi për një gjë që duhet të zgjidhet pasi që ai është në humbje me pronën e tij personale edhe pse është prishtinas i lindur. Z. Hondozi parashtroi pyetjen se çka është bërë për të në atë pjesë aty, pasi ai është me dy ngastra, te fundi i "Nartelit" që kanë ndërtuar së fundmi, tek "Përroska e Matit" ose kolektor siç po quhet, por kolektori s'është askund. Sipas vizatimit ai pa që aty po i merret një copë, ndërsa pjesa tek restorant "Bashça" po i merret e gjitha.

Përparim Rama- Kryetar, u shpreh se është në dijeni të vendit dhe "Përroskës" dhe se është filluar ndërtimi i "Rrugës A" ose "Jim Xhema" e cila në projekt e ka edhe kolektorin. Kryetari ftojë në takim zotërinë në fjalë. Tutje ai shpjegon që rruga "Jim Xhema", është një projekt që s'ka ndodhë që 12 vite dhe që ka qenë në pritshmëri 12 vjeçare ose më shumë, kurse tani është bërë brenda 18 muajve, kështu që ai ritheksoi se janë duke punuar me një ritëm të shtuar për ti zgjidhur të gjitha problemet, mirëpo kërkoj që qytetarët të qëndrojnë me ta, se është për të mirën e të gjithëve, gjithë kryeqytetit. Kryetari kërkoj nga kryesuesi që të lexohen disa pyetje.

Florim Krasniqi- Kryesues, kërkojë që të merren edhe dy pyetje nga qytetarët e pastaj të vazhdohet me pyetje që janë bërë në formë të shkruar.

Halim Maliqi shtroj një pyetje konkrete, personale për parcelën e tij 1868/2 në Zonën C5 ku 40 e diçka ari ka mbet dhe është në qendër të asaj zone pa rrugë. Ai pyeti se si është e menduar se edhe në planin e parë, në realitet gjatë diskutimit publik, ka qenë rruga andej por me intervenimet e njerëzve që kanë pas interesa, rrugën që ka kaluar për skaj parcelës së zotërisë e kanë shtyrë më andej, ndërsa ai kam mbetur i mbyllur e të tjerët marrin leje. Sipas Z. Maliqit e vetmja parcelë në atë zonë që ka mbetur pa rrugë është parcela e tij, dhe se ai beson që është paraparë ndonjë ndërkushtëzim të atyre fqinjëve kur marrin leje. Ai tregoj se parcela është në kufij me çerdhen e planifikuar, çerdhja është e paraparë në 1868/1, ndërsa ky është aty afër.

Bastri Tërnavë- qytetar theksojë se kanë ardhur në takim për tërë lagjen komplet e jo për individ sepse për individë duhet të shkojnë ku janë organet tjera. Ai mendon se kur të bëhet Plani Rregullator lagjes do ti zgjidhet problemi, e po ashtu çdo individ. Sipas tij projekti 1 apo si janë ndarë, ai projekt 1 ka shume mangësi të mëdha, duke filluar me gjelbërim e shumë gjëra tjera që kanë mangësi në atë ligj. Z. Tërnavë foli për ligjin 2, i fundit ku janë disa rregullore që kanë bërë një far ndryshimi, e atyre u intereson kjo me

pa se çka është bërë ndryshim dhe çka ka punuar kryetari që iu ka thënë atyre si banorë. Ai u shprehë se çka po iu intereson atyre, në qoftë se diku mbetet gjelbërim, kush do të merr vendim për këto që do ti ndryshojnë dhe me hy në kompensim me kompanitë, një kompani cilado që është, ajo kompani nuk të merr parasysh në qoftë se ti e ke gjelbërim. Në këtë rast ai e ka pas gjelbërim, me shtëpi është prej 2002 kur e ka ndërtuar, dhe në 2005 kur kanë bërë projekt "Model Sllovenia" kur ka ardhur për të ndërtuar aty, atë nuk e ka marrë parasysh sepse ka thënë që zona je tij është gjelbëruese dhe nuk ka çka të bëjë. Tërnavë theksojë se qysh atëherë, ata duan ta dinë çka është problemi me banorët e "Kalabrisë" çka po bëhet, me ua zgjidh një herë e përgjithmonë sepse ata janë 5 minuta prej qytetit, pra tua tregojnë konkret çka do të bëhet me qytetarët e "Kalabrisë".

Arbër Sadiki- Drejtor, shkurtimisht tha se e kupton që secili ka hallin e tij mirëpo nuk ekziston mundësia të përpilohet plan i cili fokusohet vetëm në probleme të individit me u zgjidhë tërësia por çka po bëhet është që te ky plan të plan është të përcaktohen disa mënyra të reja të implementimit, të cilat nuk e lënë anash asnjërin i cili ka kontribut për hapësirat publike. Ai ceku se problemet e qytetarëve si p.sh tek pjesa e restorantit, edhe pjesa e hapësirës së gjelbër që është pjesa më e madhe e hapësirës së gjelbër, që e ngritën pyetjen, edhe e tjetrit që është ky shiriti, pra tek asnjëra ai tha se nuk janë duke folur që kanë me qenë tash e tutje vullnet i ndërtuesit, në qoftë se donë me marrë ose jo por ai ka me qenë i kushtëzuar mu ulë deri në përqindjen e caktuar që detyrimisht ka me marrë pjesë me atë përqindje. Sipas tij kjo i bie që gradualisht qysh të zhvillohen blloqet ku parashihet ndërtimi, të shpronësohen edhe hapësirat ku është dedikimi publik, dhe si shembull mori "Kodrinat", rast i cili ka funksionuar jo keq. Për punën e rrugës ai u përgjigj që ka blloqe të cilat janë pak më të mëdha, në të cilat nuk është paraparë ndonjë rrugë e brendshme për shkak se munden me u zgjidhë edhe me rrugë të brendshme të bllokut, mirëpo në qoftë se dikujt i bllokohet një parcelë e madhe kadastrale, e cila mund të zhvillohet edhe vetë, pa ndihmën e tjetrit atëherë duhet me pa mundësinë se si mundet me u futë edhe një arterie. Drejtori Sadiki potencoi që arsyeja pse janë mbledhur në takim nuk është për të prezantuar një gjë "merr e lë" por është për të prezantuar diçka të cilën munden me u ulë për ta modifikuar deri në momentin kur arrin ti plotësojë kërkesat e qytetarëve. Ai u sugjerojë qytetarëve që të mos nisen me këtë mënyrën se si janë implementuar planet deri tash, që ka dashtë me të marrë ndërtuesi, të ka marrë, s'ka dashtë ka ecë tutje edhe me atë 20% e famshëm ka vazhduar. Sipas tij kjo nuk do të ndodhë më sepse do të jenë të rregulluara saktësisht për secilin bllok se cili, ku e merr pjesën të cilën detyrimisht duhet ta shpronësojë për të vazhduar tutje, përndryshe nuk zhvillohet as ai, dhe kjo funksionon, sidomos te rasti i qytetarit te shiriti edhe më lehtë funksionon.

Qytetari propozoj që 40% me ja lënë ndërtim, e 40% me lënë gjelbërim, pra aty të organizohet kjo pjesa e gjelbërimit, e jo tash prona e tij komplet me u futë në gjelbërim, por sipas tij s'ka mundësi, s'bëhet ajo punë. Sipas tij bëhet, blloku me bllok, e organizon andej-këndej, e largon bllokun me bllok, e fut një pjesë të gjelbërimit aty dhe të gjithë janë të kënaqur por edhe komuna në të njëjtën kohë është e kënaqur kur e merr dhe e obligon

investitorin me lanë një pjesë të gjelbërimit, ama parcela e tij komplet në gjelbërim, po ashtu edhe parcelat e të tjerëve komplet gjelbërim, e gjitha kjo në të mirë të komunës. Qytetari pyeti se çka pa ai prej komunës, përveç dëmeve, andaj ai u shprehë se po donë edhe ai një të mirë se është qytetar i këtij vendi.

Florim Krasniqi- Kryesues, tha se do ti marrin edhe dy pyetje e pastaj do ti lexon të tjerat pyetje që kanë ardhur me shkrim.

Faton Zeka falënderojë ata që i kanë mbledhur në takim si dhe qytetarët e pranishëm duke thënë që e dinë shumë mirë që është një hall shumë i madh në lagjen “Kalabria” dhe është bërë një odisejadë e këtij plani që moti kohë dhe se sipas tij e kanë pasur një plan, i cili është anuluar në këtë asamble.

Përparim Rama- Kryetar, reagoi duke thënë që nuk e kanë pas.

Faton Zeka replikoi duke thënë se e kanë pas një plan, i cili ka qenë i miratuar dhe i publikuar në gazetë zyrtare dhe se nëse kryetari e lejon do ta shpjegoj kronologjikisht qysh ka shkuar ajo punë. Ai tha se ai plan është miratuar prej një kuvendi legjitim komunal, i cili e ka kaluar edhe ligjshmërinë e ministrisë sepse i ka kaluar afatet ligjore dhe si qytetarë, kur e kanë diskutuar me kryetarin janë dakordu me pritë një periudhë që të përmirësohet planin dhe absolutisht nuk ai nuk mendon që ndonjëri është kundër gjelbërimit.

Për punën e tokenizimit z. Zeka u shpreh që është shumë e qartë dhe shumë e mirë me ndodhë por në hapësirën ku jetojnë blloku C3 (që u përmend), poshtë dhe lartë janë ndërtuar ndërtesat, d.m.th nuk ka hapësirë për tokenizim aty, bash te rripi i gjelbërimit, dhe iu drejtua Drejtor Arbërit, duke i thënë se është e pamundur me u bë tokenizimi. Sipas tij, pyetja tjetër legjitime është, çka me bë me kontrata që janë bërë aty, qysh mi zgjidh, kur investitorët p.sh nuk pranojnë me marrë toka tjera. Pra ai theksojë që kanë kontrata të cilat i kanë pasur prej periudhës kur është miratuar ai plan sepse ata kanë pas me filluar me ndërtim në pranverën e vitit 2022 por është anuluar plani dhe kanë mbetur të bllokuar për shkak të planit. Lidhur me skenarët z. Zeka mendon që skenari 2 mundet me qenë më i pranueshëm për qytetarët, kurse skenari 1 e komplikon komplet situatën, dhe se po mundohet me qenë shumë i qartë dhe dashamirës sepse në fund të fundit aty do të jetojnë shumica prej tyre dhe iu duhen edhe parqe, edhe gjelbërim, edhe shkolla. Ai u shprehë se te pjesa lartë, ku është ajo hapësira gjelbërim i madh, ka që kanë marrë leje aty edhe në blloqe dhe ata a kanë marrë leje me 1.8 , dhe ai nuk e dinë si kanë me tokenizu atë pjesën e gjelbërimit të madh, edhe pse atje ka më shumë hapësirë se sa pjesa që është ndërtuar këtu.

Z. Zeka tha se iu kanë mbetur vetëm edhe dy parcela poshtë, afër “Rrugës A”, pra ajo pjesa “Ali Vitia”, “Sicilia”, “Sylejman Vuqitërrna”, në ato rrugë që ndodhë por edhe ajo kodër ku është C3. Ai iu drejtua Drejtor Arbërit, duke i thënë se është më profesionist se në punën e ndërtimeve se është arkitekt por është e pamundur me koqit atë kodër pa i qitë blloqet e ndërtimeve dhe betonin me shtylla, me diafragma për me koqitë atë kodrën, sepse kanë marrë leje, kanë ndërtuar lartë, ka ndërtuar edhe ky poshtë dhe ka mbetur veç

ai rripi aty pa u ndërtuar, për arsye se në të kaluarën ka qenë në konservim një pjesë, një pjesë gjelbërim, e një pjesë tjetër gjë. Z. Zeka tha se nuk po duan asgjë më shumë, veç me ju përmbajt asaj që është premtuar, që plani do të mbetet i njëjti, përveçse do të ndryshohen hapësirat ku do të vendosen shkollat e çerdhet dhe organet tjera publike.

Naser Krasniqi- qytetar, përshëndeti kryetarin dhe ekipin që ka hartuar këtë plan. Si përfaqësues i familjes Krasniqi ai shpali një hall e për një pronë të tyre që është në zonën F1-7, 1582/1 dhe 1582/2, aty ku është ndërtuar kolektori, d.m.th kolektori është ndërtuar buzë pronës së tyre dhe se kanë qenë shumë bashkëpunues gjatë kohës kur është bërë kolektori por komplet

lumi është bartë në pronën tyre, e për tri vite që është ndërtuar ata nuk kanë qenë pengesë por kanë qenë bashkëpunues pa marrë parasysh që kanë pasur dëm. Sipas tij tash vjen pyetja, për komplet pronën që është diku 57 ari dhe është e sakatosur, d.m.th me këtë plan "Jim Xhema" dhe rruga tjetër që vjen e lagjes që e lidhë, plus një rrugë prapa komplet pronën

tyre 90% ua merr. Ai pyeti se çka bëhet me këtë punë duke theksuar se ai nuk po flet për zonat e gjelbra që ishte fati i tyre mirëpo kjo që po thonë me lënë në mëshirë të ndërtuesve, ka peripeci që i dinë edhe ata, pasi që edhe vetë janë ndërtues. Tutje Krasniqi tregoj që planifikimi i tyre ka qenë që në pronën e tyre të ndërtojnë vetë, jo me ja dhënë dikujt, e tash komplet prona e tyre i jepet rrugës, plus një rrethrotullimi që është bërë aty. Për fund ai bëri një pyetje për koeficientin që këtu ka qenë 1.8 ose 1.5 dhe duke kërkuar sqarim pasi që në dy takime sipas tij është thënë që koeficienti nuk ndryshon por është premtuar që ka me qenë edhe më i lartë, e jo më i ulët. Z. Krasniqi ceku që premtimi ka qenë që të bëhen pjesë komunikuese, çerdhe, gjelbërim, shkolla për arsye se në planin e mëhershëm kur është bërë 2.8, nuk kanë qenë këto të planifikuara.

Përparim Rama-Kryetar, shpjegoi se sikurse Drejtori Arbër e shpjegoi edhe ai përpara, që të gjitha këto nuk janë në mëshirë të ndërtuesit por janë ashtu të rregulluara që nuk mundet me marrë lejen ndërtuesi pa e shpronësuar pronën e cila është për të mirën publike, e cila në këtë rast është prona e Z. Krasniqi dhe se dokumenti të cilin tani janë duke e hartuar i ka të gjitha këta parametra, d.m.th është rregullore që s'mundesh m'i ikë.

Luan Pllana-qytetar i lagjes "Kalabria" fillimisht përshëndeti kryetarin dhe të pranishmit, i cili pas dëgjimit të Planit Rregullues për "Kalabrinë", tha se më shumë do të përqendrohet tek një koeficient që u përmend 2.4 i cili u tha që nuk do të ndryshojë mirëpo ky koeficient është premtuar që nuk do të preket qysh në tubimin e kaluar, ku ai tha se kanë protestuar si lagje dhe u është premtuar që kjo do të zyrtarizohet deri në shtator. Ai tha se shtatori kaloi, erdhi viti tjetër, kaluan 8 muaj, e me kalimin e kohës edhe rrethanat ndryshojnë, pasi që tash, pra edhe ky koeficient 2.4 për banorët është i pamjaftueshëm, për arsye se 10% duhet transaksioni mall për mall të paguhet, tatim në burim 10% dhe kur hiqet 10%, koeficienti bie deri në 2.1 ose 2.2. kështu që ai propozoj që ky koeficient të rritet.

Berat Gajtani, pretendenti për trashëgimtar në atë pjesën tha se në momentin që aprovohet plani i ri, banorët që janë në zonën e gjelbër do të privohen nga e drejta e pronës dhe atij po i interesojnë afatet kur do të mund ta realizojnë të drejtën, d.m.th qysh janë afatet për tokena dhe realizimin e të drejtës me metra katror të tjerë. Ai u interesua të dijë si parashihet kjo dhe se a ka komuna ndonjë fond të metrave ku do të kenë qasje me zgjedhë ndoshta edhe në pjesë tjera, apo është veç e lidhur me lagjen ose me pronën ngjitur që është.

Përparim Rama- Kryetar, u shprehë se pyetja është me vend duke u përgjigjur se aspekti i tokenizimit për momentin është i menduar në lagjen "Kalabria", pra në çfarëdo pjese të lagjes "Kalabria", mirëpo nuk do të thotë që nuk mund të përdoret edhe në pjesë tjera. Pra sipas tij edhe në pjesë tjera ku ekziston mundësia duhet të shfrytëzohet mundësia, kur duhet p.sh qasje në hapësirë publike për ta shfrytëzuar këtë pikë ku p.sh ka vende tjera ku duhen shkolla, apo çerdhe, zgjerim i rrugëve dhe mund të shfrytëzohet kjo e mirë publike që i jepet lagjes "Kalabria" për me dhënë koeficient, diku tjetër.

Arbër Sadiki- Drejtor, u shprehë se kush jeton në atë lagje në Prishtinë e sheh me çfarë dinamike është duke u zhvilluar Prishtina në kuptimin e ndërtimit. Për tokenët ai tha se, masa më e madhe kanë për tu shpenzuar gjatë realizimit të blloqeve brenda vetë "Kalabrisë", kështu që ai nuk sheh që ka nevojë me pas ndonjë afat kohor, sepse shumica e zonave publike do të fillojnë ta realizojnë të drejtën e tyre menjëherë. Ai potencoi se leja e parë që fillon e jepet me Planin Rregullues të ri do ta ketë kushtin, varësisht se nuk dihet tash sa është përqindja e hapësirave publike por aq sa është përqindja e hapësirave publike për bllokun, secili në atë përqindje do ta ketë detyrimisht ta shpronësojë gjegjësisht ta përfshijë në ndërtim, pasi sipas tij ai shpronësimi i bije që banorët me marrë pjesë në atë ndërtim me atë përqindje dhe ky realizim bëhet vazhdimisht gjatë ndërtimit. Përsëri ai e përmendi rastin e parë që është ndoshta jo më së miri por megjithatë ka dhënë rezultate si formulë, pra rasti i "Kodrinave", ku atje është pak më e dendur, ndërsa sipas tij këtu mund të realizohet edhe më mirë sepse dendësia është pak më e vogël dhe me pas edhe kualitetin më të mirë. Drejtori theksoj se e kupton hallin e banorëve mirëpo gjërat janë duke u kalkuluar matematikisht që mos me pas nevojë me hy pastaj në marrëveshje që nuk janë të parapara te plani cili në momentin që kalon në kuvendin komunal dhe e merr miratimin nga ministria, është ligj, pra ato formula që përshkruhen brenda këtij plani, ato kalojnë bëhen ligj, nuk ka më aty punë vullneti por punë implementimi. Ai tha se edhe nëse ndërrohet mbreti, këto mbesin ashtu se kuvendi i miraton.

Florim Krasniqi-Kryesues, lexoj disa pyetje, të cilat kanë ardhur, nga Hafiz Buzuku, Albertin, bashkëpronarët e familjes Janjeva, Naser Gashi, Nafiz Gjinovci, të cilët i kanë shqetësimet e njëjta që ndërlidhen me hapësirat e gjelbra dhe me zonat për shërbime të përgjithshme. Ai tha se të gjitha këto veçse u diskutuan nga kryetari dhe nga Drejtori Arbër, që do ta kenë trajtimin e njëjtë me tokena . Në pyetjen e radhës një qytetar pyet kur do të hiqet hekurudha në zonën industriale e cila nuk është aktive që nga viti 1981?

Pyetje tjetër është nga Burim Uka, i cili pyet se çka do të ndodhë me pronat e tyre, të cilat nuk janë të përkthyer.

Z. Krasniqi u përgjigj duke thënë se, çështja e përkthimeve, është në indirencat e institucioneve tjera, siç janë: gjykata, Drejtoria e Kadastrit dhe se nuk janë në pozitë që të përgjigjen por agjensioni po.

Burim Uka, u ndërlihdh me pyetjen që kishte bërë me shkrim, duke pyetur se a ka mundësi për të ndërhyrë, për ti përshpejtuar procedurat, p.sh kur i vjen plani dikujt afër, mos me qenë pengesë ajo toka që është e pa përkthyer, a duhet me pritë, se gjyqi po vazhdon tash 3-4 vite, gjyqtari ka dal në pension dhe s'kanë mund ta perfundojnë atë lëndë që është në gjyq, e cila shumë ka zgjatur.

Florim Krasniqi- Kryesues, pyeti nëse ka pyetje tjera, dhe ja kaloi fjalën të interesuarës.

Qytetarja pasi përshëndeti kryetarin tregoi për një problem që e kanë një pjesë e qytetarëve të lagjes "Kalabria", lidhur me kompleksin banesor "Model Sllovenia", që janë me ndërtim mbi shtëpitë e tyre, e të cilët për një kohë të gjatë disa vjeçare janë duke bërë lëshimin e ujërave gjithë kompleksit, mbi shtëpitë tona. Ajo ceku se ato iu kanë paraqitur një problem shumë të madh dhe kanë dalë edhe në media, që në fakt ka pas edhe shembje të dheut, problem ky për të cilin është lajmëruar edhe Ujësjiellësi dhe Komisionet, mirëpo nuk kanë marrë masa as Inspekcioni, i cili ka thënë që nuk na interesojnë pronat private. Qytetarja shprehu se do të donte një përgjigje më konkrete, d.m.th ne momentin që përmendet që është fjala për kompleksin e Model Sllovenisë, ata thjeshtë e lënë si punë dhe nuk merren.

Përparim Rama-Kryetar i propozoi qytetares që ti lente të dhënat dhe kontaktin për ta bërë një takim me Drejtorinë e Urbanizimit, për ta diskutuar çështjen sepse kjo është çështje serioze nëse ka të bëjë me ujërat e zeza.

Qytetarja shtoi se ky kompleks nuk është i kyçur fare në rrjetin e kanalizimit, d.m.th e bëjnë me radhë, e lëshojnë herë tek një shtëpi, herë te tjetra, deri në momentin që bëhet problemi shumë serioz, që ka ndodhë deri tek shembja e mureve.

Korab Janjeva, përfaqësues i familjes Janjeva tha se pyetja që ai shkroi më herët në letër nuk patë lidhje me gjelbërim por ka qenë për koeficientin prej 2.4 në 1.5, ku gjatë të gjitha takimeve u është premtuar që të paktën koeficienti 2.4 nuk do të rrëzohet, e në pjesën e tyre veç paska ndodhë dhe për ta kjo është e papranueshme sepse sipas tij 1.5 është shumë pak aty.

Përparim Rama-Kryetar, deklaroi se ai ka folur në bazë të vendimit që është marrë në asamble para 1 viti e gjysmë, apo 1 vit e 6-7 muaj tash, ku ceket thotë "koeficientet që

kanë qenë 1.8 me u bë 2.4" dhe sipas tij ashtu siç thotë ashtu është votuar, pra e kanë mbajtur fjalën, ndërsa për tjerat, të mëparshmet i kanë mbajtur qysh ka qenë gjendja ekzistuese, d.m.th nuk e kanë ndërruar, as nuk e kanë zbritura as nuk e kanë rritur, pra atë që thuhet në vendimin që është marrë në asamble, ajo është baza.

Hafiz Buzuku, banor i lagjes te te Parku i Madh F4/1 pyeti se a ka mundësi tui tregojnë banorëve pasi ua kanë marrë një pjesë të zonës së gjelbër, sa e kanë koeficientin?

Përparim Rama-Kryetar, u përgjigj duke thënë se aty koeficienti ka qenë 0, d.m.th s'kanë pas koeficient fare, ndërsa tani janë duke shqyrtuar këtë pikë në aspekt të koeficientit, duke e bërë të mundur që askush mos të mbetet pa koeficient. Për zonat e gjelbërta apo këto që kanë qenë 1.5 ose fshati që ka qenë P+2, ai tha se s'kanë ndryshuar as në fazën e parë e as në fazën e dytë dhe se propozojnë që të mbeten të njëjta, këto që janë private, ndërsa këto që janë për shoqëri, për të mirën e të gjithëve, që janë zonat e gjelbra, këtyre u jepet koeficienti cili është i bazuar me këto tjerat, d.m.th që koeficienti, tash mund ta marrim bazë, ose prej fshatit, ose prej qytetit, ose prej zonave përreth, mirëpo edhe ajo transferohet edhe në koeficient të tjerë. Kryetari potencoi që ata nuk janë duke u marrë me ndryshimin e asaj çka është marrë vendim këtu, por ajo çka po ndryshojnë është veç mos me lënë siç ka qenë 0, pra tani nuk është 0.

Hafiz Buzuku, replikoi duke iu drejtuar kryetarit se kur kanë biseduar vjet në shkollën në "Emshir" ai iu ka premtuar që do të jetë 2.4 për tërë lagjen dhe tash sipas tij prapë s'po ia tregon saktë sa është kuota nëse ai dëshiron të bëjë marrëveshje me një ndërtues. Pra qytetari tha se po i duhet toka se janë bllokuar.

Përparim Rama-Kryetar, u përgjigj duke i thënë z. Buzukut që tokën e ka pas të bllokuar më përpara dhe se tani po punojnë për ta zhbllokuar pasi që më parë z. Buzuku nuk ka pas mundësi me bë kurrë hiq aty, kurse tash me rregullativat që janë duke i bërë këta që ndërtojnë duhet ta shpronësojnë një pikë të gjelbër sepse përndryshe nuk mund ta marrin lejen, jo vetëm këtu por në të gjitha pjesët e tjera. Sipas tij aty o fol për "Kalabrinë" por në pyetjen se a mund të bëhet edhe diku tjetër, ai tha se kur kemi rastin për hapësirë publike d.m.th për të mirën e vendit, e të kësaj zone, mund të bëhet edhe tjetër kund, edhe në zona tjera, e këtu s'ka qenë 2.4, as në 1.5 s'ka qenë 2.4.

Ai citoj dokumentin e asamblesë i cili thotë "1.8 është bërë 2.4", duke thënë që atë po e mbajnë, po ashtu zonave të gjelbra që janë hapësira publike po iu japim koeficient e jo 0 por po transferohen në pika të ndërtimit. Kryetari tha se 1.5-shat rrinë 1.5-sha, fshati rrinë fshat se është P+2, d.m.th ndërtesat e vogla që janë të ndërtuara aty, një numër i madh i kanë oborret dhe rrinë oborre me shtëpi por tash e kanë parkun, e se kanë pas, s'kanë pas çerdhe, kanë me pas çerdhe, s'kanë pas shkolla, kanë shkolla, ndërsa ajo çka është marrë vendim herën e kaluar që thotë, 1.8 bëhet 2.4, ajo po bëhet. Kryetari ceku se çka ata po bëjnë shtesë është që po e heqin limitin e ndërtimit të lartësisë që mund të zhvillohet përmbi, se ajo do ta kishte krijuar një lloj hapësire.

Florim Krasniqi-Kryesues, kërkoi që ti lexoj disa pyetje që kanë ardhur.

Një pyetje vije nga Ifetja e cila thotë: “kam pronë në bllokun B3 dhe konstatojmë që gjerësia e bllokut B3 duhet të harmonizohet apo të zvogëlohet”.

Z. Krasniqi u përgjigj duke z.nj Ifete që sigurisht që do të rishikohen të gjitha formësimet e infrastrukturës në përgjithësi, dhe se ky është një proces të cilin e kanë zhvilluar dhe siç e din edhe z.nj Ifete meqenëse është arkitekte, profilet apo gjerësitë e infrastrukturës rrugore janë të përcaktuara saktësisht me norma teknike të planifikimit.

Pyetja tjetër ishte nga **Gent Krasniqi** i cili pyet: “pse nuk futet në kushte ndërtimore që nën 1 hektar të mos jepen leje ndërtimore”?

Z. Krasniqi u përgjigj se ideja ideja e organizimit të blloqeve është përtej kësaj, përtej 1 hektarësh-i dhe se ideja është që me lënë blloqe sa më të mëdha, në mënyrë që investitori potencial të bëjë organizmin e bllokut duke i marrë në konsideratë edhe tokenët, të cilët kryetari i shpjegoi në detaje.

Minush Krasniqi, thotë që: “keni premtuar koeficientin 2.4 minimum ndërsa në fotografi shihet që koeficienti është 1.5 përgjatë “Rrugës A”.

Adem Zeka, qytetar iu drejtua kryetarit duke thënë që sa i përket koeficientit që tha ai zotëria, nëse futet ky gjelbërim tek investorët , atëherë çdo investor e ka obligative mi marrë 30%, tash ky koeficient vetvetiu bie, sepse investitori e merr p.sh një parcelë ta zëmë 70 ari dhe ai i llogaritë ata 70 ari për ata banorë, e tash edhe 30% të banorëve do ti merr prej tjetër kujt. Ai po ashtu bëri pyetjen se a e kanë matë forcën e asaj toke që do të shkojë 15 kat, pasi që sipas tij s'ka shanse që të shkojë 15 kat se bien të gjitha poshtë sepse nuk guxohet të shkohet 15 kat.

Përparim Rama-Kryetar, iu drejtua qytetarit duke i thënë që tash i ka hyrë në profesion, pasi që midis zallit është ndërtesa më e lartë në botë dhe se përket aspektit të inxhinierisë nuk ka kurrfarë problemi, kështu që kryetari kërkoi që të mos brengoset për atë punë.

Qytetari tha se për 1.5 koeficienti p.sh, ajo ka me marrë “Rruga Statovcëve” një parcelë aty dhe koeficientin qenka 1.5. Sipas tij askush nuk ka mundësi ta lëshoj edhe rrugën për 1.5 sepse ajo po kompensohet por po kompensohet me 1.5. Ai iu drejtua kryetarit duke i thënë që nuk ka mundësi të lëshohet me 1.5 për ndërtim, pra pse ta lëshoj rrugën kur s'ka për të ndërtuar.

Florim Krasniqi-Kryesues bëri një sqarim për Skënder Berishën që e bëri pyetjen më herët në lidhje me hekurudhën, duke thënë se nuk e ka të qartë a është fjala për hekurudhën e cila kalon tek “Kosova-Tex” dhe “Tjerrtorja”. Ai theksoj se janë duke rishikuar edhe atë pjesë por edhe pjesën e hekurudhës e cila ka qenë e planifikuar qysh me Planin Strategjik Zhvillimor e cila ndërlidhet prej “Stacionit të

Autobusëve”, shkon përgjatë “Rrugës A” në drejtim të “Prishtina e Re”. Z. Krasniqi shpjegoi se janë duke e shikuar modalitetin se sa është e qëndrueshme të mbetet ai vizion që ka qenë dikur.

Tutje ai pyeti se a ka pyetje tjera?

Qytetari bëri një pyetje si në vazhdim, "te "Statovcët" që tha 1.5, d.m.th mua te gjelbërimi më merren 4 ari, koeficienti ka qenë 1.8 vjet, e tash është 1.5, tash d.m.th mua më merret toka kolektori ku është dhe ti ma kompenson tokën me koeficient. Kjo faktikisht po i bie, unë po jap tokë dhe po e rrisë koeficientin me para të mia jo prej komunës, se toka d.m.th po më shkon mua".

Përparim Rama-Kryetar, u përgjigj rreth shqetësimit të qytetarit duke i thënë që nuk po i shkon toka, se ai po e merr atë si pagesë.

Qytetari iu drejtua kryetarit duke i thënë se nuk e ka të qartë ndoshta nga mosdija por toka po i merret. Ai morri shembullin e Janjovalive, duke thënë se ju merren gati 41 ari e krejt janë 90 ari, d.m.th 47-48% u merret toka dhe prapa këtyre është gjelbërim dhe se nuk po e kupton koeficienti qysh rritet kur merret toka.

Përparim Rama-Kryetar, shpjegoi se në zonat ku ka sens, për tu ngritur lartë, deri tani e ke pas limitin, s'ke mund të shkosh më lartë, e tash mundesh deri ku ka sens. Sipas kryetarit ku s'ka sens prapë ke mundësi, d.m.th ke metra katror të lejueshëm si tokenizim, m'i bartë në ndërtim tjetër, brenda zonës, d.m.th nuk të shkojnë huq ato, të paguhen, pra koeficienti rrinë 1.5 por toka që të merret, të jepet prapë me atë koeficient, nuk të humbë.

Florim Krasniqi-Kryesues, iu lut të pranishmëve për pak qetësi, duke sqaruar që përveç këtij takimi do të ketë mundësi takimi edhe në zyre, në baza individuale apo grupe në mënyrë që të jepen sqarime sa më të hollësishme. Ai ftojë të gjithë ata që duan sqarime individuale të shkojnë të martën dhe të enjten, në Drejtorinë e Planifikimit për sqarime të nevojshme lidhur me planin dhe procesin në përgjithësi.

Bastri Tërnavë, qytetar u shpreh se i kupton qytetarët që kanë halle. derte mirëpo të gjithë kanë. Ai kërkoi sqarim për zonën 2, planin 2 se çka po bëhet problemi dhe çka do të bëhet me të. Gjithashtu qytetari pyeti kryetarin se qysh e ka vendosë 1-shin, pasi atë problem ata e kanë pasur që 20 vite dhe tash duan të din me planin e ri me na treguar çështjen e projektit 2.

Përparim Rama-Kryetar, u shprehë se ai e shpjegoi më shumë se një herë por po e sheh që s'po e kuptojnë, andaj ju ofroj takime për tua shpjeguar në detaje Planin 1(A) dhe Planin 2(B), si dhe të mirat dhe të këqijat e dyjave. Ai po ashtu u theksojë se nuk po vendoset sot që a po shkojmë për planin A ose B, por vetëm po diskutohet për të gjet më të mirën. Sipas kryetarit dhe shpjegimit të tij, pse njëra, pse tjetra asnjëra nuk e dëmton pronarin apo shfrytëzuesin e asaj hapësire por krijohet mundësia, në A një version dhe në B një version tjetër e cila sipas tij si urbanist është më e mirë. Ai është i bindur se qytetarët

do ta kuptojnë sepse do të takohet me ta dhe do tua shpjegojë në detale, duke iu drejtuar një qytetari që nuk e ka kuptuar dhe se opsionet janë për ta bërë më mirë e jo më keq. Kryetari për rastin e shumëçekur të "Kodrinave" deklaroi se nuk ishte shembull i mirë për ta përgjithësuar por shembull i mirë i tokenizimit, jo projektin, jo gjelbërimin por mënyrën e tokenizimit, formula për mos ta lënë askënd jashtë, jo çka kanë bërë me dizajnë pasi me atë dizajn Z. Rama nuk pajtohet.

Qytetari iu drejtua kryetarit duke i thënë që veç nëse e gjen ti atë investitor ja japim 20 hektarë sepse s' dimë ku e gjejmë.

Çështja e dytë tha se ajo toka për të cilën po bëhet fjalë te C3-shi, është aq pjerrtësi, që s' të duhet as për park , tutje ai vazhdoi duke thënë se a ka ndonjë eksperiment, a është luajtur ndonjë lojë, apo kanë dashur ti shtinë me bë zhurmë, nuk e din por ajo tokë s' ju duhet send.

Përparim Rama-Kryetar, kërkoj që mos të bastardohet diskutimi pasi që ideja është për ta krijuar më të mirën për të gjithë qytetarët aty. Ai iu drejtua qytetarit duke i thënë që "e keni një mundësi ku ti po donë me hy në mes të dy ndërtesave që janë ekzistuese aty, me prishë jetën e atyre njerëzve që jetojnë aty por edhe tënden, ti atë po donë ta bësh, se s' po të intereson të dëgjosh çka jam duke thënë". Tutje kryetari vazhdoi me shpjegimin duke i thënë që nuk e lëmë keq, dhe nëse nuk do ti interesonte ai do ti thoshte qytetarit "shko ndërtoje", por ai u shprehë se atij po i intereson për qytetarin por qytetarit për vete jo. Edhe në këtë rast kryetari ofroj bashkëpunim dhe takim për ti diskutuar detalet, në rast se personi në fjalë nuk e ka kuptuar.

Bekim Tërnava, njëri prej pjesëtarëve të lagjes, pasi dëgjoj disa herë që u përmend fjalia " po takohemi individualisht", theksojë se shumë prej qytetarëve janë vonuar në fillim të takimit dhe nuk kanë mbërri ta dëgjojnë saktë planin, dhe kërkojë që të shpjegohet edhe një herë në pika të shkurta.

Përparim Rama-Kryetar, u përgjigj që projekti u shpjegua prej fillimit, dhe se i vije keq që ka ardhur me vonesë por për ta shpjeguar nga fillimi nuk ka kohë, pasi që të gjithë pjesëmarrësit kanë familje por qytetarit i ofroj që të dalin atje dhe t'ia shpjegojë që të mos ti mbajnë të tjerët sepse u shpjegua një herë. Ai edhe një herë u tregua i gatshëm për të caktuar terminë për t'iu shpjeguar atyre që s'po i kuptojnë detalet..

Besim Krasniqi, qytetar nga lagja "Kalabria" pyeti në lidhje me organizimin e takimeve individuale sepse aty po merren vesh pak më mirë.

Mimoza Sylejmani - Drejtore, sqaroi se do ta bëjnë një listë dhe do ta postojnë në faqen e Drejtorisë për Planifikim , do ta qesin orarin dhe qytetarët mund të vijnë një nga një, dhe do tua shpjegojnë të gjitha, bashkë me Grupin Punues.

Florim Krasniqi-Kryesues, njoftoj të pranishmit që duan takime individuale të nënshkruajnë në listë, bashkë me numrin, kontaktin dhe imellën, në mënyrë që t'i kontaktojnë pastaj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim publik për fillimin e hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”.

Dt. 26.5.2023

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	ALBERT	LEHOCI			
2	ELSADAT	REXHEPI			
3	ADEM	ZEKA			
4	XHEMHIR	KRANIQI			
5	BASRI	TERNAVA			
6	FLORIM	MUSTAFA			
7	BURIM	UKA			
8	DRILON	BEGOLLI			
9	BEDRI	BYTYCI			
10	GJIMOS	LIPOVICA			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	SKENDER BERISHA	BERISHA			
12	Shkurt	Krasniqi			
13	Shkurt	Krasniqi			
14	VALMIR	TRNAVA			
15	MILATIM	IBRAHIMI			
16	SHOMSI	KILICAJ			
17	AHMET	MEROLLI			
18	BAKI KULLOQI				
19	EREM	THAGI			
20	HAFIZ	BUZOKU			
21	DINI	MUSTAFA			
22	Shkurt	Pobërdeli			
23	FATON	NEZIRI			
24	GEMAJ	KRASNIQI			
25	Kaltrina	UKA			
26	Kujtim	VEKRI			
27	BASRI	BEGOLLI			
28	RITOR	BEGOLLI			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29	DARDAN ZOGJINI	
30	NAKIDE QERIMI	
31	Musli Byku	
32	Edon Byku	
33	MUHAMED KRASNIAI	
34	IORIZ STAROUCI	
35	FLAMOR	DERGUSHA
36	SHRUMBIN IZHARI	
37	Zekri	Zabeli
38	Ilir	Krasniqi
39	Besim	Krasniqi
40	MEKITAR	Paçulca
41	Anam Krasniqi	
42	LADINOT KRASNIAI	
43	LORIK KRASNIAI	
44	DRITON BAJRAMI	
45	GENI KRASNIAI	
46	RAMË K	KRJETI

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47	IFETA	NIJQEVIR			
48	BEKIM	TERMANI			
49	AGIM	ABDULLAH			
50	BAJKAM	IBRAHIMI			
51	FLORIN KRASHI	KRASHI			
52	HASRAT KRASHI	KRASHI			
53	BAJRAM SEDI	SOPI			
54	Minush Krasniqi				
55	Adem Krasniqi	QKOJ			
56	Raudat Pllana				
57	LUAN	PLLANA			
58	ENVER	OSMANI			
59	HALIM	MALIQI			
60	LULZEM	KRASHI			
61	PERDARIM	KRASHI			
62					
63					
64					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Diskutim publik për fillimin e hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”
26.5.2023

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nönehkrimi/Signature
1	Muharrem	Hondazi			
2	BLERIM	Mujku			
3	Janiq Ahmet				
4	KORAB	JANJEVA			
5	HABIB	AHMETI			
6	Vedat Olu	OLLURI			
7	Adem KRASNIQI				
8	Luan Pllana	PLLANA			
9	LAVDAT	PLLANA			
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj konsultimi të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail - TEL.	Nënshkrimi/Signature
11	BAJRAM	SOPË			
12	Dautan	Çezhëdriu			
13	Karli	Deleu			
14	Rgji	Afiu			
15	AMIR	Alchimeti			
16	BASPI	KRASNIQI			
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------